REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

VENDIM

NR. 160, DATË 25/11/2019

PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2020

Mbështetur në gërmën "f", të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në V.K.M nr 132, datë 07.03.2018 " Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe regullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 " Për financat e vetqeverisjes vendore", në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 "Për Gjendjen Civile", i ndryshuar, ligjin 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", ligjin 8519 datë 30.07.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", i ndryshuar, ligjin 9385 datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, ligjin 10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", ligjin 10279 datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", Këshilli i Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2020 si vijon:

1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.
Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Shkalla tatimore

- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë, është 0 (zero) lekë në vit.
- Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 5(pesë) për qind.

Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë.
Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor.
Në rast se aktiviteti i biznesit hapet, mbyllet apo pezullohet gjatë vitit fiskal, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël është proporcional me kohën e zhvillimit të aktivitetit dhe llogaritet në bazë të vetëdeklarimit të tatimpaguesit. Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë gjatë vitit, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin llogaritet në bazë të qarkullimit dhe të fitimit të tatueshëm, të parashikuar nga vetë tatimpaguesi, për periudhën nga data e regjistrimit deri në fund të vitit të parë kalendarik.
Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, tatimi për t'u paguar, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. Detyrimin për paraqitjen e deklaratës vjetore në afatin e mësipërm e kanë edhe të gjithë tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet.

Administrata Tatimore Qendrore, për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1(një) për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore.

2. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

a) taksa mbi ndërtesën

b) taksa mbi tokën bujqësore

c) taksa mbi truallin

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë

2.a) Taksa mbi ndërtesat

Përkufizime:

"Çmim vlerësues", njësia matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar.

"Ndërtesë", objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.

"Ndërtesë e papërfunduar", objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

"Njësi pronësore", ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë". Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.

"Ndarje e njësisë pronësore për banim", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.

"Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.

"Përdorues", individi, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.

"Taksapagues", çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

"Vlerë e pasurisë", Vlera e pasurisë është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore.

"Veprimtari ekonomike", çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në ligj përcaktohen ndryshe.

- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
- Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
- Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit.

➢ Çmimi mesatar referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi për Bashkinë Korçë është 45,800 lekë/m².

➢ Çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtesat që nuk shërbejnë për banim janë si më poshtë vijon:

1. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe proçese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.
2. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
3. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit në qytet.
4. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse.
5. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.
6. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit, të cilat iu bashkuan njësive të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, reduktohet deri në 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.
7. Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit, vetëm në rastin e shitjes së parë.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:
a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambiente të hipotekuara si:

- Apartamente banimi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë " ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim".
- Njësi biznesi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike".
- Bodrum/parking i mbuluar do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "ndërtesa që përdoret për parkim të mbuluar dhe bodrume".

Për sa i përket kategorisë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;

b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.

Për sa i përket kategorisë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës.

Afatet e pagesës

1. Detyrimi vjetor për kategorinë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim do të shpërndahet për periudhën Janar 2020 – Dhjetor 2020 dhe do të paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, pranë sporteleve të Ujësjellës Kanalizime Korçë. Për të gjitha familjet e tjera të cilat nuk kanë një kontratë të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve me ndërmarjen e Ujësjellës Kanalizime Korçë detyrimi vjetor për taksën mbi ndërtesës do të paguhet pranë sporteleve të bankave të nivelit të dytë për Njësinë administrative Korçë dhe pranë sporteleve të njësive administrative për njësitë e tjera administrative brenda datës 31.12.2020.

2. Detyrimi vjetor për kategorinë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike do të paguhet brenda datës 30.06.2020 .

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.
Përjashtohen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:
a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
ë) ndërtesat e banimit të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie / pension social kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë ose dhe me persona në ngarkim të tyre që janë të pa aftë për punë;
f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën për biznesin është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Korçë.
Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën për familjarët është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Korçë, agjenti tatimor UKKO, administratorët e lagjeve (për njësinë administrative Korçë) kurse për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është njësia administrative.

2.b) Taksa mbi tokën bujqësore.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit, është detyrim vjetor dhe paguhet brenda datës 31.12.2020. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të

mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore. Pas vetëdeklarimit Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore mund të bëjë verifikimin sipas vlerësimit të rastit në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përllogaritet për të gjithë periudhën.
Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.
Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Vlera e taksës në lekë/hektar/vit
I	4,200
II	3,500
III	2,800
IV	2 300
V	1,900
VI	1,600
VII-X	1,400

Detyrimi vjetor për kategorinë tokë bujqësore për qëllime biznesi do të paguhet brenda datës 30.06.2020.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Përjashtohen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Përjashtime
Përjashtohen nga taksa mbi tokën bujqësore, tokat bujqësore që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për biznesin është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Korçë.
Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për familjarët është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Korçë, administratorët e lagjeve (për njësinë administrative Korçë) kurse për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është njësia administrative.

2.c) Taksa mbi truallin.

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit dhe është detyrim vjetor i taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim. Pas vetëdeklarimit Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore mund të bëjë verifikimin sipas vlerësimit të rastit në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përllogaritet për të gjithë periudhën.
Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror.
Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi truallin është si vijon:

Bashkia	Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës në lekë/m²/vit për qëllime biznesi
Bashkia Korçë	0,42 lekë/m²	18 lekë/m²

Afatet e pagesës

Detyrimi vjetor për kategorinë truall për qëllime banimi nga individët do të shpërndahet për periudhën Janar 2020 – Dhjetor 2020 dhe do të paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, pranë sporteleve të Ujësjellës Kanalizime Korçë. Për të gjitha familjet e tjera të cilat nuk kanë një kontratë të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve me ndërmarjen e Ujësjellës Kanalizime Korçë detyrimi vjetor për taksën mbi truallin do të paguhet pranë sporteleve të bankave të nivelit të dytë për Njësinë administrative Korçë dhe pranë sporteleve të njësive administrative për njësitë e tjera administrative brenda datës 31.12.2020.

Detyrimi vjetor për kategorinë truall për qëllime biznesi do të paguhet brenda datës 30.06.2020.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Përjashtohen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për biznesin është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Korçë.
Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për familjarët është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Korçë, agjenti tatimor UKKO, administratorët e lagjeve (për njësinë administrative Korçë) kurse për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është njësia administrative.

3. TAKSA E FJETJES NË HOTEL.

Me **"hotel"** kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel, për person. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel".

Kategoritë minimale të taksës së fjetjes në hotel	**Bashkia Korçë**
Hotelet 4-5 yje	175 lekë për natë fjetje
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	70 lekë për natë fjetje

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.
Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.
Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Korçë.

4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA.

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë nga 4 për qind deri në 6 për qind të çmimit të shitjes për metër katror për qytetin dhe për njësitë administrative taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë 4 për qind të çmimit të shitjes për metër katror, sipas hartës bashkëngjitur këtij vendimi.
Për banesat e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave për strehimin e familjeve të pastreha, pavarësisht nga zona ku ndërtohet, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë 4 për qind të çmimit të shitjes për metër katror.
Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe do të jetë si më poshtë:

- Për objekte deri në 250 m² niveli i taksës do të jetë:
  - Qyteti Korçë 3%
  - Fshati Voskopojë 3%
  - Njëstë Mollaj, Drenovë, Voskop dhe Bulgarec 2%
  - Njësitë Lekas, Vithkuq dhe fshatrat e tjera të njësisë Voskopojë 1%

- Për objekte mbi 250 m² niveli i taksës do të jetë 3% në të gjithë territorin e Bashkisë Korçë

Për objektet banesa për përdorim vetiak dhe njësi shërbimi llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë bëhet sipas kostos së ndërtimit për m². sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit, ndërsa për objektet me karakter bujqësor, blektoral dhe industrial llogaritet sipas vlerës së preventivit.

Në këtë rast përfshihen edhe investimet për ndërtime që shërbejnë për banim të realizuar nga vetë investitori dhe që destinohen për përdorim vetiak të investitorit dhe jo për qëllime shitjeje, pavarësisht se ky ndërtim realizohet me shoqëri ndërtimi apo nga vetë investitori.

4. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

5. Për ndërtesat, të cilat janë në proçes legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Për ndërtimet në proçes

legalizimi, objekt i dytë, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të llogaritet si ndërtimet e reja që trajtohen me leje ndërtimi (Pika 2 dhe 3).

6. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

7. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

8. **Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse:**

- investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*".
- investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
- investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Struktura e ngarkuar për dhënie leje ndërtimi është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Korçë.
Struktura e ngarkuar për përllogaritjen e vlerës së taksave dhe tarifave dhe vjeljen e tyre është Drejtoria e Financës.

5. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës.
Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij sipas tabelës që vijon :

Kategoritë e ndërtesave	Njësia Administrative Korçë	Njësitë e tjera Administrative
	Zona 2 (Lekë/m2)	Zona 3 (Lekë/m2)
I. Ndërtesa banimi	300	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	700	300
III. Ndërtesa të tjera	500	200

Shënim I: Në të gjitha njësitë administrative të tjera zbatojnë nivelin e taksës për zonën 3

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agjentit tatimor, përfiton 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

6. TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA.

Drejtoritë Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura bazuar në legjislacionin në fuqi, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës 30 të çdo muaji, për llogari të organeve tatimore të administratës qëndrore dhe njësive të qeverisjes vendore.
Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Rtransportit Rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njësive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit.
Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të D.R.SH.T.RR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 25 (njëzet e pesë)% të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore, dhe 75 (shtatëdhjetë e pesë)% të të ardhurave, D.R.SH.T.RR-ja e derdh për llogari të drejtorisë rajonale, ku është regjistruar (drejtoria rajonale e tatimpaguesve të mëdhenj).
Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të D.R.SH.T.RR-së me organet tatimore të administratës qëndrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.
Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

7. TAKSA E TABELËS.

Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizike, juridike, private e shtetërore, vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkisë Korçë.
Tabelat karakterizohen:
I) Tabelë për qëllime identifikimi,e trupëzuar ose jo,brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për te reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit);
II) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orioentim;
III) Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme ose e palëvizshme ;
IV) Tabelë për funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola,e.t.j.

Niveli i kësaj takse për Bashkinë Korçë është si më poshtë vijon :

I.	**Taksë tabele për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, kuzhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit)**		
a	***deri në 2 m²***	lekë/m²/vit	0
b	***mbi 2 m² deri në 10 m²***		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m²/vit	10,000
	me ndiçim të thjeshtë	lekë/m²/vit	15,000
	elektronike	lekë/m²/vit	20,000
c	***mbi 10 m² deri 20 m²***		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m²/vit	8,500
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m²/vit	12,750
	elektronike	lekë/m²/vit	17,000
ç	***mbi 20 m² deri 40 m²***		
	e thjeshtë(pa ndriçim)	lekë/m²/vit	5,500
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m²/vit	8,250
	elektronike	lekë/m²/vit	11,000
d	***mbi 40 m²***		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m²/vit	4,000
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m²/vit	6,000
	elektronike	lekë/m²/vit	8,000
II.	**Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim**		
	Tabela identifikuese	lekë/m²/vit	120
III.	**Tabela për qëllime reklamimi e lëvizëshme e palëvizëshme deri në tavanin maksimal 35 m²**		

	e thjeshtë (me/ pa ndriçim)	lekë/m²/vit	22,500
	elektronike	lekë/m²/vit	45,000
IV.	**Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda, reklamuese, banderol, etj.**		
	të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m²/ditë	1,000

- Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë.
- Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së tatimpaguesit, apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës, shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga gërma të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura apo të mbështetura mbi një sipërfaqe ekzistuese (mur, fasadë, shtyllë, kollonë, apo të ngjashme me to) dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë të shkruara, stampuara, apo pikturuara brenda saj, si bazë vlerësuese për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zenë të gjitha shkronjat, figurat, logo dhe simbolet që formojnë tabelën.
  Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihet edhe gërma, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produktesh apo shërbimesh që furnizohen nga vetë njësia ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabele.Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.
Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife për familjarët rezidentë efektivë është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Korçë, agjenti tatimor UKKO, administratorët e lagjeve (për njësinë administrative Korçë), kurse për njësitë e tjera administrative, struktura e ngarkuar është njësia administrative.

8. **Tarifë "Lejë 24 orë"** është tarifë e cila do të paguhet nga subjekte të cilët do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbas orarit të lejuar dhe që do të pajisen me lejën përkatëse për të zhvilluar aktivitetin e tyre mbas këtij orari. Leja 24 orë do tu jepet atyre subjekteve të cilët plotësojnë kriteret për tu pajisur me këtë lejë nga Bashkia Korçë.

   Struktura e ngarkuar për dhënie "leje 24 orë", përllogaritjen e vlerës së kësaj tarife dhe vjeljen e detyrimit është Drejtoria e Kontrollit të Territorit e Bashkisë Korçë.

   Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje dhe mos zbatim të saj (bazuar në rregulloret përkatëse) është Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe Policia Bashkiake.

9. Për subjektet të cilat janë anëtarë të shoqatës ZZHB të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre tregëtar në zonën BID në lidhje me tarifat që krijohen nga bizneset e kësaj zone do të zbatohen përcaktimet e V.K.M nr 918 datë 04.10.2013 "PËR MIRATIMIN NË PARIM, TË MARRËVESHJES. NDËRMJET BASHKIVE SHKODËR, KORÇË, BERAT, FONDACIONIT SHQIPTARO-AMERIKAN PËR ZHVILLIM DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "ZONË PËR ZHVILLIM E BIZNESIT-ZZHB"
   - Për subjektet që përfshihen në zonën BID të miratuar me VKB duhet ti paguajnë detyrimet sipas vlerës dhe afateve të përcaktuara për llogari të Bashkisë Korçë dhe kjo e fundit do i transferojë këto të ardhura në llogarinë e shoqatës brenda datës 31.05.2020. Për subjektet të cilat do i paguajnë jashtë këtij afati duke marë parasysh dhe penalitetet transferimi i tyre do të bëhet brenda datës 30.09.2020.
   - Për subjektet që përfshihen në zonën TID sipas marëveshjes së miratuar me V.K.B, duhet ti paguajnë tarifat e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit sipas vlerës dhe afateve të përcaktuara për llogari të Bashkisë Korçë dhe kjo e fundit do i transferojë këto të ardhura në llogarinë e shoqatës TID KORÇA brenda datës 31.05.2020. Për subjektet të cilat do i paguajnë jashtë këtij afati duke marë parasysh dhe penalitetet transferimi i tyre do të bëhet brenda datës 30.09.2020.

Struktura e ngarkuar për transferimin e të ardhurave në llogaritë përkatëse të shoqatave është Drejtoria e Financës.

10. **Tarifë për dhënien në përdorim të tubacioneve nëntokësore, për shtrirjen e linjave nëntokësore (telefoni, energji, tv kabllor, internet).**
Baza e tarifës për dhënien në përdorim të tubacioneve nëntokësore për shtrirjen e linjave nëntokësore (telefoni, energji, tv kabllor, internet) është gjatësia lineare për kilometër e linjave nëntokësore e cila vihet në përdorim për shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim vjetor i subjektit duke shumëzuar bazën e taksës (gjatësinë lineare për kilometër) me nivelin tregues të saj.
Struktura e ngarkuar për për identifikim dhe matjen është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.
Struktura e ngarkuar për lidhjen e kontratave për dhënien në përdorim të tubacioneve nëntokësore, për shtrirjen e linjave nëntokësore (telefoni, energji, tv kabllor, internet) është Drejtoria Juridike.
Struktura e ngarkuar për përllogaritjen e tarifës për dhënien në përdorim të tubacioneve nëntokësore, për shtrirjen e linjave nëntokësore dhe për vjeljen e saj është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Korçë.

11. **Përcaktimi i vendndodhjes së biznesit.**
Taksapaguesit biznes i vogël apo i madh janë të detyruar të paguajnë tarifat dhe taksat vendore mbi biznesin për çdo vendndodhje biznesi, në përputhje me nivelin e tarifave dhe taksave vendore të përcaktuar për llojin e biznesit sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë.
Bizneset nën administrimin e të njëjtit taksapagues që ushtrohen në një vendndodhje (në një godinë) do të taksohen dhe tarifohen gjithnjë si vendndodhje biznesi më vete.
Një "vendndodhje biznesi" është një zonë e dallueshme dhe e ndarë si në të njëjtën godinë, ashtu edhe në godina të ndryshme, konkretisht:
a) Kur veprimtari të ndryshme ekonomike kryhen nga një taksapagues në të njëjtën dhomë, konsiderohen si një vendndodhje e një biznesi.
b) E njëjta veprimtari ekonomike e kryer nga një taksapagues në dy dhoma, që kanë komunikim nga brenda, konsiderohen një biznes, pra konsiderohen si një "vendndodhje biznesi".
c) Dy veprimtari të ndryshme ekonomike të kryera nga një taksapagues në dy dhoma, që kanë komunikim nga brenda, konsiderohen dy biznese, pra konsiderohen si dy "vendndodhje biznesi".
d) Disa veprimtari ekonomike të ndryshme ose e njëjta veprimtari ekonomike e kryer në dy dhoma fqinje, që nuk komunikojnë me njëra – tjetrën nga brenda, konsiderohen dy biznese, pra konsiderohen si dy "vendndodhje biznesi".

TARIFA TË SHËRBIMIT ADMINISTRATIV TË BASHKISË KORÇË

1) TARIFA TË SHËRBIMIT ARKIVOR, VËRTETIME NGA ZYRAT DHE KOMISIONE PËR SHËRBIMIN PRANË ARKËS SË BASHKISË

- Tërheqje Vendime të Këshillit Bashkiak dhe Vendimeve për miratim leje ndërtimi/zhvillimi **50 lekë/fletë**
- Tërheqje e gjithë dokumentave të tjera përveç atyre të sipërpërmendura dhe njëhsim i tyre me origjinalin nga Arshiva e Bashkisë Korçë **50 lekë/fletë**

2) TARIFA PËR SHËRBIMIN NË FUSHËN E TRANSPORTIT TË PASAGJERËVE & MALLRAVE DHE DHËNIEN E LEJEVE PËR USHTRIM AKTIVITETI NGA SEKTORI I KONTROLLIT JO USHQIMOR DHE LIÇENSIMIT PRANË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT TË BASHKISË KORÇË

Nr.	Emërtimi	Njësia	Tarifa në lekë
I	**TRANSPORT UDHETARËSH**		
	Brenda vendit		
1.	Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse.	Për linjë	80,000 (10-vjeçare)
	➢ Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse.	Për mjet	1,000 (1-vjeçare)
2.	Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse.	Për linjë	40,000 (10-vjeçare)
	➢ Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse.	Për mjet	1,500 (1-vjeçare)
3.	Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse ushqyese (deri 15 km).	Për linjë	75,000 (5-vjeçare)
	➢ Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse ushqyese (deri 15 km).	Për mjet	1,500 (1-vjeçare)
4.	➢ Liçencë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të udhëtarëve.	Për linjë	20,000 (5-vjeçare)
	➢ Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të udhëtarëve.	Për mjet	1,500 (1-vjeçare)
5.	Liçencë për kryerjen e shërbimeve vajtje – ardhje, të udhëtareve.	Për linjë	20,000 (5-vjeçare)
	➢ Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve vajtje – ardhje, të udhëtareve.	Për mjet	1,500 (1-vjeçare)
	➢ Çertifikatë për transport udhëtarësh për llogari të vet	Për mjet	1,500 (1-vjeçare)
	➢ Autorizim i përkohshëm (1 mujor) në transportin e udhëtarëve	Për autorizim	2,000 lekë

6.	Liçencë për transport udhëtarësh me taksi	Për mjet	20,000 (5-vjeçare)

Nr.	Emërtimi	Njësia	Tarifa në lekë
II	TRANSPORT MALLRASH		
	Brenda vendit		
1.	Liçencë për transport mallrash për të tretë dhe me qira.	Për liçencë	40,000 (afati 5-vjecar)
	➢ Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira.	Ton/kapac.	100 *
2.	Çertifikatë për transport për transport mallrash për llogari të vet.	Ton/kapac.	100 *
3.	Çertifikatë për tërheqës dhe automjete të tjera të cilat nuk kanë kapacitet transportues.	Për mjet	1,500 (në vit)
III	SHËRBIME TRANSPORTI		
1.	Liçencë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit.	Për liçencë	15,000 (afati 5-vjecar)
2.	Liçencë për agjensi transporti ndërkombëtar udhëtarësh.	Për liçencë	40,000 (afati 5-vjecar)
3.	Libër udhëtimi për shërbime të rastit brenda vendit	Për libër	12 500 lekë

Shënime :

a) Vlera e dalë nga llogaritja e ton/kapacitet do të shumëzohet me numrin e viteve sipas kërkesës së subjektit për kohëzgjatjen e dokumentit.

b) Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30% e vlerës së plotë.

c) Për rastet e ndryshimeve në liçencë/çertifikatë që kanë të bëjnë me elementet e përdoruesit të mjetit, fushës së operimit etj, paguhet 30% e vlerës së plotë.

d) Për rastet kur subjektet figurojnë debitorë dhe kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi për pagesë me këste të detyrimeve, liçencat dhe çertifikatat do të jepen me afat 1 vjeçar.

e) Për autorizimet e mjeteve (kryesisht për kamionët e tonazhit të rëndë të transportit, betonierat dhe presat e betonit,) që hyjnë në rrugët me kalldrëm, bulevarde, trotuare apo bordura duhet të specifikohet në autorizim detyrimi për të riparuar dëmet e shkaktuara. Në rast se subjekti nuk respekton kushtin e vendosur në autorizim, ky i fundit humbet vlefshmërinë e tij.

- Tarifë shërbimi për liçencë, çertifikatë ose autorizim në fushën e transportit 200 lekë.
- Tarifë për paisje me emblemë taxi 200 lekë/copë.

- Dhënie autorizimi për lëvizje të automjeteve mbi 3,5 ton brenda unazës për periudha të përkohshme.

  * Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 3,5 T – = 7,5 T
  3,000 lekë/vit/mjet ose 250 lekë/muaj/mjet

  * Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 7,5 T – = 12 T
  6,000 lekë/vit/mjet ose 500 lekë/muaj/mjet

  * Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 12 T – = 18 T
  9,000 lekë/vit/mjet ose 750 lekë/muaj/mjet

  * Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 18 T
  12,000 lekë/vit/mjet ose 1,000 lekë/muaj/mjet

- Dhënie autorizimi për lëvizje frekuente të autotobusëve në qytet.

  *Autobusë deri në 20 vende 6,000 lekë/vit/mjet ose 500 lekë/muaj/mjet
  *Autobusë nga 20 - 30 vende 9,000 lekë/vit/mjet ose 750 lekë/muaj/mjet
  *Autobusë mbi 30 vende 12,000 lekë/vit/mjet ose 1,000 lekë/muaj/mjet

  Shënim: Përjashtohet nga pajisja me autorizim autobusët e subjekteve të cilat operojnë me linja të rregullta qytetesë si dhe autobusët për qëllime turistike

3) TARIFA TË SHËRBIMIT NË ZYRËN E GJENDJES CIVILE

Transferimi i të dhënave të gjendjes civile nga Zyra e Gjëndjes Civile të Vendbanimit të mëparshëm në atë të vendbanimit të ri jashtë afatit 30 ditor, Gjobë	**10,000 lekë**
Për procedurën e veçimit / bashkim familjesh të shtetasve	**1,000 lekë**
Për mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës	**1,000 lekë**
Për lëshim dokumenti çertifikatë për leje lidhje martese në gjuhë të huaj	**200 lekë**
Lëshim çertifikate martese në gjuhë të huaj	**200 lekë**
Lëshim çertifikate	**50 lekë**
Lëshim çertifikate lindje në gjuhë të huaj	**200 lekë**
Për regjistrimin e shtetasve të huaj, pas dhënies të shtetësisë shqiptare	**2,000 lekë**

Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe vjeljen e këtyre tarifave janë zyrat e gjëndjes civile në Bashkinë Korçë.

4) TARIFA TË DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

a) Shqyrtimi i kërkesave për Leje Ndërtimi pranë Bashkisë Korçë :

- Kërkesa për leje ndërtimi për rikonstruksione dhe struktura banimi individuale **500 lekë**
- Banesa të grupuara, kolektive, dhe të gjitha llojet e tjera jo banim **2,000 lekë**

b) Tërheqje leje përdorimi :

- Për banesat e grupuara dhe kolektive si dhe për të gjitha objektet e tjera përveç atyre me destinacion banim **50 lekë/m²**
- Për banesa individuale **20 lekë/m²**

c) Fotokopjimi i planshetave në shkallën 1/500, 1/2000 :

- Format A4 **200 lekë**
- Format A3 **300 lekë**

d) Tarifë për aplikim Leje Zhvillimi **5,000 lekë**

Strukturat e ngarkuara për vjeljen e këtyre tarifave janë Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Financës në Bashkinë Korçë.

5) TARIFA PËR RAJONET ADMINISTRATIVE

- Lëshim vërtetimi për banor lagjeje **100 lekë**
- Lëshim formulari për të pastrehët **100 lekë**
- Dhënie firme për hipotekimin e pronave private që janë të kufizuara me pronën publike **500 lekë**

Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe vjeljen e këtyre tarifave janë rajonet administrative pranë Bashkisë Korçë.

D. TARIFA TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË

1) NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE KORÇË

- Lëshim vërtetimi **100 lekë/vërtetim**
- Dhënie me qira autovinçin **3,500 lekë/orë**
- Dhënie me qira autokoshi **3,500 lekë/orë**
- Dhënie me qira rimorkjatori **12 lekë T/km**
- Prerje asfalti me prerësen e asfaltit **100 lekë/m linear**
- Shëtitje me tren në parkun e qytetit **50 lekë/bileta**
- Vizitë në kullën panoramike **50 lekë/bileta**
- Përgatitje dokumentacioni për privatizim objektesh të kthyera në fond banese **200 lekë**

- Lëshim librezë për qira banese **50 lekë**

- **Çmimi i shitjes së drurëve sipas moshës së tyre :**

Nr.	Emërtimi i bimësisë	Mosha e drurëve dhe çmimi i shitjes/lekë				
		1-3 vjeçare	4-6 vjeçare	7-10 vjeçare	11-15 vjeçare	mbi 15 vjet
1	Bredh (Hormoq)	150	3,000	5,000	7,000	10,000
2	Pishë	150	3,000	5,000	7,000	10,000
3	Cedrus	150	3,000	5,000	7,000	10,000
4	Selvi	100	1,500	2,000	2,500	3,000
5	Mështekna	100	2,500	2,500	3,500	5,500
6	Gështenja	100	2,500	3,500	4,500	6,000
7	Panja amerikane	200	1,000	1,500	2,500	3,000
8	Panja mali	300	1,000	2,000	3,000	4,000
9	Katalpa	500	1,000	1,500	2,000	2,500
10	Kumbull e kuqe	100	1,500	2,000	2,500	3,000
11	Sofora	200	1,000	1,500	2,500	3,500
12	Lojfata	200	1,000	1,500	2,500	3,500
13	Plepa	50	100	200	300	500
14	Blinj	100	200	3,000	4,000	5,500
15	Akacje dhe Glediçe	100	500	800	1,000	1,250
16	Frashër	300	600	800	1,000	1,500
17	Shelgje	50	100	200	500	800
18	Ara indi	300	700	1,100	1,600	2,000
19	Rrap	100	1,000	3,500	4,500	3,000
20	Hunap	100	1,000	3,500	4,500	3,000
21	Verri	100	1,000	1,500	2,000	2,500

- **Çmimi i shitjes së shkurreve dekorative sipas moshës së tyre :**

Nr.	SHKURRE	Mosha e shkurreve dhe çmimi i shitjes/lekë				
		1-2 vjeçare	3-4 vjeçare	5-8 vjeçare	9-10 vjeçare	mbi 10 vjet
1	Trëndafila	100	200	300	400	500
2	Ligustra	60	120	1,500	2,000	2,500
3	Tuja e zakonshme	200	400	3,000	6,000	8,000
4	Tuja lejland	200	400	6,000	8,000	10,000

5	Tuja aurea	200	400	6,000	8,000	10,000
6	Tuja zmeral	100	400	3,000	4,000	5,000
7	Dëllinjë kineze	100	400	3,000	5,000	7,000
8	Qershiçka	100	300	500	700	1,000
9	Spirea	100	300	500	700	1,000
10	Hibiskus	100	300	500	700	1,000
11	Budlea	100	300	500	700	1,000
12	Forsythje	100	300	500	700	1,000
13	Citisus	100	300	500	700	1,000
14	Cidonja	100	300	500	700	1,000
15	Jargavanë	100	300	500	700	1,000
16	Filadentrus	100	300	500	700	1,000
17	Vegelia	100	300	500	700	1,000
18	Bignoja	100	300	500	700	1,000
19	Keria	100	300	500	700	1,000

- **Çmimi i shitjes së luleve në vazo :**

Nr	Emërtimi	Çmimi/lekë
1	Aspiragus	300
2	Fikus	900
3	Shqiponjë	1,000
4	Sedium	400
5	Mastika	400
6	Bela perona	400
7	Aloe arborensu	400
8	Lule akulli	300
9	Karfica	300
10	Livando	300
11	Atallzi	300
12	Ruskus	300
13	Beganja	400
14	Palma uji	400
15	Fier	400
16	Klorofikum	200
17	Aspidistra	200
18	Zambak i kuq	200
19	Gjemb me pika	300
20	Tradiskania lila	200
22	Palm e zakonshme	600
23	Filadentrum	400
24	Ksindapsus	300
25	Sansaverina	400

26	**Ekeveria**	300
27	**Kaktus**	400
28	**Sterlica**	1,000
29	**Dafina**	600
30	**Hedera**	400
31	**Karafila në vazo**	100
32	**Kalla bisqe**	30
33	**Gladiola**	30

- **Çmimi i shitjes së kurorave dhe buqetave me lule :**

Nr	Emërtimi	Çmimi/lekë
1	**Kurora me lule**	2,500
2	**Kurora për familjarë**	1,500
3	**Buqeta feste**	1,000
4	**Buqeta të mëdha**	500
5	**Buqeta e thjeshtë**	100

- **Tarifat për ujitjen:**

Nr	Emërtimi	Vlera
1	**Tarifa e ujitjes me rrjedhje të lirë**	100 lekë/dynym
2	**Tarifa e ujitjes me pompë**	50 lekë/dynym

Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe vjeljen e këtyre tarifave është Ndërmarrja e Shërbimeve Publike

- **Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes:**

Nr	Emërtimi	Vlera
1	**Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes**	200 lekë/dynym

Struktura e ngarkuar për krijimin e regjistrit, identifikimin e fermerëve të cilët duhet ta paguajnë këtë tarifë, sipërfaqet e tokave të cilat vaditen dhe përllogaritjen e kësaj tarife është Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ndërsa për vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Korçë.

2) <u>NDËRMARJA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË ARSIMIT DHE ÇERDHES</u>
Kuota ushqimore mujore që paguhet nga prindërit për 8 (tetë) kopshtet dhe 1 (një) çerdhe në territorin e Bashkisë Korçë janë si më poshtë vijon :

- Kopshti nr 1 **125 lekë në ditë**

➢ Kopshti nr 2	**125 lekë në ditë**
➢ Kopshti nr 3	**125 lekë në ditë**
➢ Kopshti nr 5	**125 lekë në ditë**
➢ Kopshti nr 6	**125 lekë në ditë**
➢ Kopshti nr 9	**125 lekë në ditë**
➢ Kopshti nr 11	**125 lekë në ditë**
➢ Kopshti nr 12	**125 lekë në ditë**
➢ Çerdhe	**125 lekë në ditë**

Përjashtohen nga pagesa e tarifës ushqimore nëpër kopshte fëmijët të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Prindër të paaftë për punë.
- Prindër të papunë ose punëkërkues.
- Raste të referuara nga Drejtoria e Kujdesit Social (raport social ekonomik specifik për familjen).

Për familjet në të cilat njëri nga prindërit është i pa punë, Bashkia Korçë do kompesojë kuotën ushqimore, për 17 lekë në ditë.

Kuota ushqimore që paguajnë nxënësit konviktore që nuk përfitojnë bursë

215.5 lekë në ditë

Tarifë qiraje për qytetaret që janë strehuar në konvikti i Shk. Mekanike

700 lekë/muaj për dhomë

Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe vjeljen e këtyre tarifave është Ndërmarja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Korçë

3) QENDRA KULTURORE "VANGJUSH MIO"

➢ Tarifa e dhënies në përdorim të sallës	**2,500 lekë/orë**
➢ Vlera e biletës për të vizituar muzeun "Bratko"	**200 lekë**
➢ Vlera e biletës për të vizituar muzeun "Bratko" për nxënësit e shkollave dhe studentët	**100 lekë**
➢ Vlera e biletës për të vizituar muzeun "Gjon Mili"	**200 lekë**
➢ Vlera e biletës për të vizituar galerinë "Guri Madhi"	**falas**
➢ Vlera e biletës për të vizituar ekspozita të ndryshme	**falas**

Për personat që janë të pajisur me kartën e studentit dhe atë të pensionistit çmimi i biletës do të jetë i reduktuar me 1/2 e vlerës së saj.

Fundjava e fundit e çdo muaji do të jetë falas për të gjithë vizitorët të cilët do të vizitojnë muzeumet Bratko dhe Gjon Mili.

4) **BIBLIOTEKA "THIMI MITKO" & "THOMA TURTULLI"**

- Tarifa e dhënies në përdorim të sallës — **2,500 lekë/orë**
- Shërbim hapje kartele biblioteka "Thimi Mitko" — **500 lekë**
- Shërbim hapje kartele biblioteka "Thoma Turtulli" — **falas**
- Shërbim interneti për anëtarët e bibliotekës "Thimi Mitko" — **falas**

5) **TEATRI "ANDON ZAKO ÇAJUPI"**

- Tarifa e dhënies në përdorim të sallës — **20,000 lekë/ditë**
- Tarifa e dhënies në përdorim të sallës (Teatri i Kukullave) — **2,500 lekë/ditë**
- Shfaqjet e organizuara për (kopshte, shkolla dhe studentë) — **100 lekë/bileta**
- Shfaqjet e lira për publikun:
  - Shfaqje të T.O.B (opera) — **1,000 lekë/bileta**
  - Shfaqje të T.O.B (balet) — **500 lekë/bileta**
  - Shfaqje të T.K — **500 lekë/bileta**
  - Shfaqje me të ftuar specialë — **500 lekë/bileta**
  - Shfaqje të teatrit "A.Z. Çajupi" dhe të teatrove të tjera — **300 lekë/bileta**

Për personat që janë të pajisur me kartën e studentit dhe atë të pensionistit çmimi i biletës do të jetë i reduktuar me 1/2 e vlerës së saj.

Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe vjeljen e këtyre tarifave është Qëndra Artit dhe Kulturës Korçë.

6) **KLUBI SHUMËSPORTËSH "SKËNDERBEU"**

- Tarifa e dhënies në përdorim të sallës së lojrave me dorë — **4,000 lekë në orë**
- Tarifa e dhënies në përdorim të muzeut të pallatit të sportit — **4,000 lekë në orë**

Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe vjeljen e këtyre tarifave është klubi shumësportësh "SKËNDERBEU"

E. LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE QË DO TË VENDOSEN NGA INSPEKTORËT E DREJTORISË SË KONTROLL TERRITORIT DHE DREJTORISË SË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË RASTET E SHKELJEVE DHE KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE

1. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa liçensë, autorizim apo lejë përkatëse.

a. Mospajisja me liçensë, autorizim apo çertifikatë përkatëse transporti : • transport udhëtarësh taksi (1+4) • transport udhëtarësh taksi (1+8) • transport udhetarësh me autobus • mjete të tonazhit të lartë • hyrja pa autorizim në rrugët e qytetit për mjetet e tonazhit të mesëm dhe të lartë • hyrja pa autorizim në rrugët e zonave historike qytetit për mjetet e tonazhit të mesëm dhe të lartë • Mospajisja me liçensë për agjensi transporti udhëtarësh kombëtare apo ndërkombëtare	10,0O0 lekë 15,0O0 lekë 20,0O0 lekë 20,0O0 lekë 15,0O0 lekë 20,0O0 lekë 20,0O0 lekë
b. Mospajisje me liçensë për tregëtimin me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndeve djegëse	20,0O0 lekë
c. Mospajisje me leje për tregëti ambulante, kantinë	1,000 deri 5,0O0 lekë
d. Mos pajisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit në hapësirë publike (trotuar, sheshe e.t.j)	20,0O0 lekë
e. Mospajisje me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh" mbas orarit të lejuar.	20,000 lekë
f. Mospajisje me leje për zënie të hapësirës publike • veprimtarive (ekspozim malli, promocione, panaire, ekspozita dhe evente të ndryshme) të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike	10,000 lekë
g. Mospajisje me leje për vendosje reklame : • e thjeshtë • elektronike	20,000 lekë
h. Në rastet e konstatimit të ndotjes akustike mbi nivelet e lejuara në ambjentet e brendshme dhe të jashtme të lokaleve.	20 000 lekë
j. Në rastet e konstatimit të muzikës me këngëtare ose me aparatura të dixhitalizuara në individualizim të çdo subjekti që operon me aktivitet tregetar (bar – kafe, bar – restorant e.t.j) në zonën e pazarit të vjetër, përveç rasteve të pajisura me leje nga Bashkia	20,000 lekë
2. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore pa lejë të posaçme.	
a. Dëmtim rruge	10,000 deri 20,000 lekë
b. Çarje rruge	10,000 deri 20,000 lekë
c. Bllokim rruge, korsi biçikletash dhe hapësira të tjera publike në të (me inerte, materiale të ngurta, mjete promocionale, konë parkimi, sende të tjera)	10,000 deri 20,000 lekë
d. Dëmtim bordure (ndryshim pozicioni fillestar, thyerje, shpërngulje e.t.j)	10,000 deri 20,000 lekë

e. Dëmtim trotuari (heqje pllakash, vendosje pusete, vendoje tendash, vendosje mjete promocionale e.t.j)	10,000 deri 20,000 lekë
f. Çarje trotuari	10,000 deri 20,000 lekë
g. Bllokim trotuari, korsi biçikletash hapësira të tjera publike në të (me inerte, materiale të ngurta, mjete promocionale, vazo lulesh, pedana e.t.j)	5,000 deri 20,000 lekë
h. Dëmtim, bllokim, vjedhje pusete	20,000 lekë
i. Ndotje të rrugëve nga mjetet e transportit të tonazhit të rëndë dhe të lëhtë : - persona juridikë - persona fizikë - banorë të qytetit dhe njësive administrative	 20,000 lekë 10,000 lekë 5,000 lekë
3. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e shpërndarjes dhe ndriçimit rrugor pa lejë të posaçme.	
a. Lidhje ose mirëmbajtje e pamiratuar në rrjetin ajror (fibra optike, kabllo shpërndaresë e.t.j)	10,000 deri 20,000 lekë
b. Dëmtim të shtyllave të rrjetit shpërndarës apo ndriçimit rrugor	15,000 deri 20,000 lekë
c. Dëmtim i ndriçuesve	10,000 deri 20,000 lekë
d. Përdorimi i shtyllave të rrjetit shpërndarës apo ndriçimit rrugor si suport për montimin e reklamave, kapjen e kabllove etj.	20,000 lekë
e. Dëmtim i traseve, kabllove dhe linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje dhe pa leje si dhe shkulja e shtyllave.	10,000 deri 20,000 lekë
4. Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit.	
a. Lidhje e pa miratuar në tubacion	10,000 deri 20,000 lekë
b. Dëmtim i pusetave	10,000 deri 20,000 lekë
c. Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje	10,000 deri 20,000 lekë
5. Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbëra dhe publike.	
a. Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta	10,000 deri 20,000 lekë
b. Dëmtim, prerje, krasitje e pemëve	10,000 deri 20,000 lekë
c. Zënie e hapësires të gjelbër (tavolina, promocione e.t.j)	20,000 lekë
d. Vendosje tabelash, pankartash, banderolash, posterash, njoftimesh në pemet dekorative	10,000 lekë
e. Mos ndërtimi i bazamenteve të kontenierëve të mbetjeve urbane të subjekteve të ndërtimit për objektet mbi 5 kate.	20,000 lekë
h. Hedhje e mbeturinave jashtë pikave të përcaktuara të depozitimit të mbetjeve organike, inetre, e.t.j.	5,000 deri 20,000 lekë

6.Niveli i gjobave per sektorin e kontrollit veterinar.	
a. Për mishin e therur të tregëtuar të pa çeritifikuar nga sektori i kontrollit veterinar	10,000 lekë
b. Mbajtja e kafshëve të prodhimit brenda territorit të Njësisë Administrative Korçë.	10,000 deri 20,000 lekë për herë të parë, për rast të përsëritur deri në konfiskim të kafshës
c. Në rast të mosmarrjes së masave për izolimin kafshëve te luksit	5,000 lekë
d. Në rast të mbajtjes së bletëve, lepujve, shpendëve (pula, pata, pëllumba, e.t.j të ngjashme me to) në ambientet e banesave kolektive apo banesave individuale brenda territorit të Njësisë Administrative Korçë.	10,000 deri 20,000 lekë
e. Në rast të konstatimit të tregëtimit të kafshëve të prodhimit jashtë tregjeve të miratuara nga Bashkia Korçë.	5,000 lekë
f. Në rast të konstatimit të therrjeve të kafshëve të prodhimit jashtë vendeve të përcaktuara nga Bashkia Korçë.	10,000 deri 20,000 lekë për herë të parë, për rast të përsëritur deri në konfiskim të kafshës
7. Niveli i gjobave për inspektorët e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.	
a. Mos deklarim i personave që kërkojnë strehim kundrejt pagesës në subjektet me emërtim hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim dhe numri i netëve të qëndruara në hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër.	20,000 lekë
8. Niveli i gjobave për mosrespektim të kushteve dhe detyrimeve kontraktuale në shërbimin e transportit publik qytetës (urban).	
a. Mos informatizimi i stacioneve me informacionet e duhura për qytetarët dhe oraret e shërbimit.	5,000 lekë
b. Vendosja e materialeve promovuese, reklamuese, e.t.j në fasadën e mjeteve të transportit publik pa miratimin e Bashkisë.	20,000 lekë
c. Mos vendosja e emërtimit të linjës dhe numrit identifikues në mjetet e transportit publik.	5,000 lekë
d. Mos respektimi i intenerarit, orarit dhe qëndrimi jashtë stacionit të miratuar	10,000 lekë
e. Mos respektimi i frekuencës të levizjes së mjeteve	5,000 lekë
f. Mos pajisja me uniformë dhe elementet identifikues përkatës për personelin e transportit publik të udhëtarëve (drejtues mjeti/fatorino).	5,000 lekë për herë të parë dhe në rast të përsëritur 10,000 lekë

g.	Në rastet e konstatimit të udhëtarëve të pa pajisur me biletën e udhëtimit apo biletat e pajtimit(abone), ndaj subjektit operues në trasportin publik të udhëtarëve, të meret masa e kundërvajtjes administrative.	5,000 lekë për herë të parë dhe në rast të përsëritur 10,000 lekë
h.	Në rastet e konstatimit të mbajtjes hapur të dyerve të mjetit të transportit publik përgjatë lëvizjes për në intenerar.	20,000 lekë
i.	Mos përdorimi i sistemit ngrohje/ftohje për krijimin e kushteve normale të udhëtarëve.	5,000 lekë për herë të parë dhe në rast të përsëritur 10,000 lekë
j.	Dalja e drejtuesit të mjetit nga mjeti gjatë intervalit të qëndrimit në stacion.	5,000 lekë për herë të parë dhe në rast të përsëritur 10,000 lekë

Struktura e ngarkuar për zbatimin e penaliteteve referuar nivelit 1,2,3,4,5 dhe nivelit 8 është sektori i kontrrollit jo ushqimor dhe liçensimit në Drejtorinë e Kontrrollit të Territorit.
Struktura e ngarkuar për zbatimin e penaliteteve referuar nivelit 6, është sektori i kontrrollit veterinar në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit.
Struktura e ngarkuar për zbatimin e penaliteteve referuar nivelit 7, është sektori i kontrollit dhe mbledhjes së të ardhurave në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

- Të ardhurat e realizuara nga mbledhja e gjobave do të ndahen sipas përcaktimit që bën Ligji Nr.10279 datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjen administrative".
- Mbeten në fuqi të gjitha gjobat e tjera që janë miratuar me ligj ose me V.K.B dhe që nuk janë përmendur në këtë material.
- Përjashtohen nga pagimi i gjobave vetëm rastet e parashikuara me ligj të veçantë.
- Për zbatimin e këtyre penaliteteve ngarkohen të gjitha Drejtoritë e Bashkisë Korçë.
- Mbeten në fuqi të gjitha taksat dhe tarifat e tjera që janë miratuar me Ligj ose me V.K.B dhe që nuk janë përmendur në këtë material.
- Për nënkategorinë **"Njësi – çdo kantier ndërtimi"**, llogaritja e tarifave bëhet vetëm njëherë përpara zbardhjes së lejës së ndërtimit.
  Struktura e ngarkuar për vjeljen e tyre është Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Korçë.
- Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Korçë vetëm pasi të kenë paguar para zbardhjes së lejes së ndërtimit detyrimet përkatëse për selinë administrative, detyrimet për **"çdo kantier ndërtimi"** si dhe pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.
  Struktura e ngarkuar për dhënie leje ndërtimi është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Korçë.
  Struktura e ngarkuar për përllogaritjen e vlerës së taksave dhe tarifave dhe vjeljen e tyre është Drejtoria e Financës.
- Për të gjitha subjektet ndërtuese që do të aplikojnë për të tërhequr lejën e përdorimit pranë Bashkisë Korçë, ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

që përpara fillimit të proçedurës në sistem për dhënien e lejës së përdorimit ti kërkojë I.M.T të verifikojë nqs është bërë riparimi i dëmtimeve në rrugët me kalldrem, bulevarde, trotuare apo bordura.

I.M.T në bashkëpunim me N.SH.P. dhe D.K.T verifikon gjëndjen e rrugëve dhe informon Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit për vijimin e proçedurës.

Struktura e ngarkuar për dhënie leje përdorimi është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Korçë.

- Të gjitha subjektet ndërtuese kontraktuese përpara fillimit të punimeve duhet të aplikojnë në Q.K.B për hapjen e adresës dytësore të vendit të ushtrimit të veprimtarisë të ndryshme nga selia (sipas vendndodhjes të objektit të kontratës) si dhe të kryejnë të gjitha pagesat për taksat dhe tarifat vendore ndaj Bashkisë Korçë për këtë vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë të ndryshme nga selia administrative.

  Struktura e ngarkuar për kontrrollin dhe moslejimin e fillimit të punimeve në rast të mos plotësimit të kushteve të mësipërme është Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave pranë Bashkisë Korçë dhe Drejtoria e Financës e cila nuk do kalojë asnjë detyrim kontraktual në rast të mos plotësimit të kushteve të mësipërme.
- Në rastet e prishjes së objekteve me rrezik shëmbje nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit shpenzimet e prishjes do ti ngarkohen nga kjo e fundit pronarëve të kësaj kategorie objektesh.
- Në lidhje me nivelin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet do të zbatohet legjislacioni në fuqi.

  Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe vjeljen e këtyre detyrimeve është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Korçë.
- Përjashtohen nga pagesa të gjitha rastet e parashikuara me Ligj.
- Mbledhja e tyre do të bëhet nga vetë strukturat e Bashkisë dhe agjentët tatimorë të përcaktuar sipas ligjit.
- Në lidhje me nivelin e taksave dhe tarifave të shërbimit për funksionet që janë transferuar në Bashki do të zbatohet legjislacioni në fuqi.

  Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe vjeljen e këtyre detyrimeve janë zyrat e krijuara për këto funksione.
- Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen të gjitha Drejtoritë pranë Bashkisë Korçë, Njësitë Administrative si dhe Institucionet e Varësisë.
- Të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë akt, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes dhe i shtrin efektet nga data 1 Janar 2020.

KRYETARI I KËSHILLIT

Erjon NEXHIPI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KORÇË